



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: *01-65*
Datë: *16.02.2017*

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ri-akreditohet "ELC" me tri dege në Prishtinë për periudhën **11.12.2016** deri **30.06.2019** për të ofruar:

1.1 Gjuhë Angleze

2. Ri-akreditimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

2.1 Të rishikojë praktikat e vlerësimit të testit përfundimtar me gojë dhe përpilojë testin me gojë ashtu që vlerësimi të jetë objektiv dhe i mbështetur në përshkrimet e KPERGJ-së.

2.2 Të bëhet ngritja e kapaciteteve të stafit mësimdhënës.

2.3 Të përpilohet formulari për identifikimin e nevojave për zhvillim profesional.

2.4 Formulari i cili ka për qëllim vlerësimin e performancës së mësimdhënësve nga ana e nxënësve duhet të thjeshtësohet dhe të përdoret gjuhë adekuate.

- 2.5 Të dhënat e mbledhura nga formularët që u jepen kandidatëve për vlerësim të kursit dhe mësimdhënësve të analizohen dhe t'u kthehen mësimdhënësve/qendrave përkatëse.
- 2.6 Të përpilohet formulari i cili do të bënte vlerësimin e menaxhmentit në formë anonime nga ana e stafit.
3. Kushtet e parashtruara për ri akreditim duhet të përmbushen deri më datën **30.04.2017**, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi u dërgohet:
- ELC;
 - AKK.



Anëtar i KD së AKK-së
Bedri Xhafa